



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 981/ Prot

Gramsh më 11/08/2024

V E N D I M

Nr. 15 datë 19/02/2024

“PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.85.DATË 27.12.2023 “PËR MIRATIMIN
E NUMRIT MAKSIMAL TË PUNONJËSVE DHE NIVELIN E PAGAVE E
SHPËRBLIMEVE, TË PUNONJËSVE E PERSONAVE, TË EMËRUAR OSE TË
ZGJEDHUR TË BASHKISË GRAMSH ”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 6, shkronja “c” dhe nenit 9, të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 113, datë 01.03.2023, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Miratimin e numrit maksimal të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve vartëse prej 385 (treqind e tetëdhjetë e pesë) punonjësish.
2. Niveli i pagave për funksionarët, nëpunësit civilë, punonjësit administrativë të Bashkisë Gramsh janë ato të miratuara sipas lidhjeve nr.1, 2 dhe 3, bashkëlidhur VKB-së, nr.85.datë 27.12.2023.
3. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i bashkisë.
4. Ngarkohen Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI

